

# PANELI KËSHILLDHËNËS I TË DREJTAVE TË NJERIUT

## RREGULLAT E PROCEDIMIT

### **Kapitulli 1. Dispozitat e Përgjithshme**

#### *Rregulla 1. qëllimi i rregullave të paraqitura*

Rregullat e paraqitura kanë për qëllim vendosjen e rregullave cilat do të përcillen nga paneli këshillëdhënës i të drejtave të njeriut dhe ato cilat paraqiten para tyre, në procedimet e mbuluara nga rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 të 23 marsit 2006 mbi themelimin e panelit këshillëdhënës të drejtave të njeriut.

#### *Rregulla 2. definicionet*

Për qëllimet e rregullave të paraqitura vetëm në rast se konteksti kërkon ndryshe:

- a. termi “Rregullorja Nr. 2006/12” nënkupton Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 të 23 marsit 2006 mbi themelimin e panelit këshillëdhënës për të drejtave të njeriut;
- b. termi “Panel” nënkupton panelin këshillëdhënës i të drejtave të njeriut;
- c. termi “ankesë” nënkupton çdo person apo grup individësh cilët kanë parashtruar një ankesë apo në emër të cilëve një ankesë është parashtruar;
- d. termi “aplikues” nënkupton ankesën cilën e ka parashtruar ankuesi personalisht, apo ndonjë anëtarë i familjes, organizata joqeveritare apo sindikata cili ka parashtruar një ankesë në emër të ankuesit;
- e. termi “përfaqësues” nënkupton personin cili përfaqëson një palë në procedimet para panelit, sipas rregullës 17.

### **Kapitulli 2. Organizimi i Panelit**

#### *Rregulla 3. Anëtarët e Panelit*

Anëtarët e Panelit duhet të shërbejnë vetëm në kapacitetin e tyre personal.

#### *Rregulla 4. Urdhri mbi precedencë*

1. Anëtarët e Panelit duhet të marrin precedencë pas Kryetarit sipas kohëzgjatjes së kaluar në zyre.
2. Anëtarët cilët kanë kaluar kohëzgjatje të njëjtë në zyre duhet të marrin precedencë sipas moshës.
3. Ri- emërimi i antarëve duhet të marrin precedencën duke pasur parasysh në kohëzgjatjen e afateve të tyre të mëparshme në zyre.

<sup>1</sup> Miratuar nga Paneli më 5 shkurt 2008. Ndryshuar më 11 shtator 2009 dhe më 21 nëntor 2009.

### *Rregulla 5. Dorëheqja*

Dorëheqja e anëtarëve duhet të njoftohet te Kryetari i Panelit cili duhet të transmetoj atë te Përfaqësuesi Special i Gjeneralit të Përgjithshëm.

### *Rregulla 6. Zgjedhja e Kryetarit*

Paneli duhet të zgjedh Kryetarin e saj, për një afat të një viti. Ai apo ajo mund të rizgjidhet.

### *Rregulla 7. Funksionet e Kryetarit*

Kryetari duhet të drejtoj punën e Panelit.

### *Rregulla 8. Zëvendësimi i Panelit*

Nëse Kryetari nuk është në gjendje të kryej detyrat e saj apo të tij, apo nëse zyra e saj apo tij është i/e lirë, detyrat e Kryetarit duhet të kryhen nga një anëtar tjetër sipas urdhrit mbi precedencë shtruar në Rregullën 4.

### *Rregulla 9. Sekretariati*

1. Sekretariati duhet të përbëhet nga Zyrtari Ekzekutiv dhe stafi tjetër profesional dhe administrativ.
2. Zyrtari Ekzekutiv duhet, nën udhëzimin e Kryetarit, të jetë përgjegjës për punën e Sekretariatit dhe, posaçërisht:
  - a) duhet të asistoj Panelin dhe anëtarët e tij në përmbushjen e detyrave të tyre;
  - b) duhet të jetë kanali i gjitha komunikimeve në lidhje me Panelin;
  - c) duhet të mbikëqyrë arkivat e panelit;

## **kapitulli 3. Funksionimi i Panelit**

### *rregulla 10. Ulësja e Panelit*

1. në pajtim me Nenin 4.1 të Rregullores Nr. 2006/12, ulësja e panelit do të jetë në Prishtinë.
2. Paneli mund të vendos të kryej funksionet e saj diku tjetër nëse përshtatet.
3. Paneli mund të vendos në cilën do fazë të ekzaminimit të një ankese, nëse është e nevojshme që një hetim apo ndonjë funksion tjetër të mbartet diku tjetër nga ajo apo nga një apo më shumë anëtar të saj.

### *Rregulla 11. Seancat e Panelit*

1. Paneli duhet të vendos datat e seancave të saj.
2. Anëtarët cilët janë të penguar nga një sëmundje apo arsye tjera serioze nga pjesëmarrja në tërë apo një pjesë të seancës të Panelit apo nga përmbushja nga ndonjë detyrë tjetër duhet, sa më shpejt që është e mundur të njoftoj mbi atë Kryetarin.

### *Rregulla 12. Tërheqja*

1. Një anëtar i Panelit mund të mos marr pjesë në konsiderimin e ndonjë rasti nëse:
  - a. ai apo ajo ka interes personal në rast;
  - b. ai apo ajo ka shprehur opinionin publikisht, nëpërmes mediave, me shkrim, nëpërmes veprimeve të saj apo tij publike apo ndryshe, cilat janë kanë aftësi objektivisht të kenë efekt jo të favorshëm në paanësinë e saj apo tij;
  - c. për ndonjë arsye tjetër, pavarësia apo paanësia e saj apo tij legjitimisht të vihet në dyshim.
2. Në rast të ndonjë dyshimi si te egzistimi i njëres prej bazave të referuara në paragrafin 1, ajo çështje do të vendoset nga Paneli, pa pjesëmarrjen e anëtarit përkatës.

### *Rregulla e 13. Shqyrtimet*

1. Paneli duhet të shqyrtoj privatisht. Shqyrtimet e saj duhet të mbesin sekret. Vetëm Zyrtari Ekzekutiv, anëtarët e Sekretariatit, përkthyesit, dhe personat cilët ofrojnë ndihmë teknike apo sekretarie Panelit mund të jenë prezent në takimet e saj, vetëm nëse Paneli vendos ndryshe.
2. Ku është e nevojshme për Panelin të vendos një pikë apo procedurë apo çfarë do pyetje tjetër nga takimet e caktuara nga Paneli, Kryetari mund të udhëzoj që shqyrtimi të zë vend nëpërmes mjeteve elektronike.

### *Rregulla e 14. Kuorum*

1. Paneli mund të vendos vetëm nëse gjithë anëtarët e saj janë prezent apo, në rast të Rregullës 13 § 2, nëse gjithë anëtarët marrin pjesë në shqyrtim nëpërmes mjeteve elektronike.
2. Në rast të dorëheqjes apo tërheqjes të ndonjë anëtari apo mungesa e saj apo tij në kuptim të Rregullës 11 § 2, Paneli mund të vendos me dy anëtar cilët janë prezent apo marrin pjesë në shqyrtim me mjete elektronike.

### *Rregulla 15. Votimi*

Vendimet e Panelit duhet të merren nga shumica e anëtarëve cilët marrin pjesë në votë. Abstenimet nuk duhet të lejohen në votat e fundit mbi pranueshmërin dhe meritat e rastit. Në rast të barazimit, Kryetari duhet të jap votën vendimtare.

## **Kapitulli 4. Procedura**

### **A. Rregullat e përgjithshme**

#### *Rregulla 16. Gjuhët*

1. Gjuhët zyrtare të Panelit duhet të jenë Shqip, Serbisht dhe Anglisht.
2. Versioni autentik të vendimeve mbi pranueshmërin dhe opinionet e meritave duhet të jenë në gjuhën angleze. Versioni anglisht duhet të përkthehet në shqip dhe serbisht.

### *Rregulla 17. Përfaqësimi i palëve*

1. ankesat dhe personat cilët vepron në emër të tyre mund të përfaqësohen para panelit nga avokatët e tyre apo përfaqësues tjerë sipas zgjedhjes së tyre.
2. UNMIK-u duhet të përfaqësohet para Panelit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm apo nga ndonjë agjent i caktuar nga ai.

### *Rregulla 18. pjesëmarrja e një Amicus Curiae dhe Ombduspersoni*

1. Paneli mundet, në pajtim me Nenin 13 të rregullores Nr. 2006/12, të ftoj në amicus curiae apo Ombduspersoni të parashtrojnë observimin me shkrim.
2. një ftesë e tillë mund të vazhdohet nga Paneli cili vepron në iniciativën e tij, apo mbi një kërkesë me shkrim nga personi apo një institucion cili është i gatshëm të marr pjesë si amicus curaie, apo nga ombduspersoni.

### *Rregulla 19. Veprimi në raste specifike*

1. Paneli mund të, me propozim të saj apo nga kërkesa e ndonjë pale, të marr çdo veprim cilën e konsideron të volitshëm apo të nevojshme për kryerjen e drejtë të detyrave të saj nën Rregulloren Nr. 2006/12.
2. Paneli mund të delegoj një apo më shumë anëtarë të saj të bëj një veprim të tillë në emër të saj, dhe veçanërisht të dëgjoj dëshmitarë apo ekspert, të ekzaminon dokumente apo të vizitoj ndonjë lokalitet. Ata apo ai anëtarë duhet të raportoj te paneli.

### *Rregulla 20. Bashkimi i ankesave*

Paneli mundet, nëse e konsideron në interes të kryerjes së duhur të procedimeve, të urdhëroj bashkimin e një apo më shumë ankesave.

### *Rregulla 21. Urdhri i procedimit të ankesave*

1. Paneli duhet të merret me ankesa në rend në cilin ato janë bërë të gatshme për ekzaminim.
2. Paneli mundet, sidoqoftë, të vendos ti jap prioritet një ankese të veçante.

### *Rregulla 22. Masat e përkohshme*

1. Paneli apo, ku është e duhur, kryetari i saj mundet, në kërkesën e një pale apo ndonjë personi përkatës, apo me propozimin e vet, ti tregoj palëve ndonjë masë të përkohshme cilën konsideron se duhet adoptuar në interes të palëve apo për kryerje të duhur të procedimeve para tyre.
2. Paneli mund të kërkoj informatë nga palët në çdo çështje në lidhje me implementimin e ndonjë mase të përkohshme cilën e ka treguar.

### *Rregulla 23. Kufizimet e kohës*

Në pajtim me Nenin 11.3 të Rregullores Nr. 2006/12, dhe vetëm nëse vazhdohet nga Paneli, kufizimi i kohës për UNMIK-un për një përgjigje mbi meritat e një ankese e deklaruar e pranishme duhet të jetë 20 ditë nga dita e pranimit të ankesës nga

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Gjitha kufizimet tjera duhet të caktohen nga Paneli, për çdo informatë, vëzhgim apo komente të kërkuara nga palët.

#### *Rregulla 24. Shpenzimet*

Në pajtim me Nenin 10.5 të Rregullores Nr. 2006/12, aty nuk parashihet ndonjë pagesë për parashtrimin e një ankesë.

### **B. Ankesat**

#### *Rregulla 25. nënshkrimi i ankesës*

1. çdo ankesë e parashtruar nën nenin 10.2 apo 10.3 të Rregullores Nr. 2006/12 duhet të parashtrohet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga aplikuesi apo përfaqësuesi i aplikuesit.
2. aty ku është parashtruar ankesa nga një person ligjor apo një grup individësh, duhet të nënshkruhet nga ata persona kompetent të përfaqësojnë atë person ligjor apo grup. Paneli duhet të vendos çdo çështje nëse personi cili ka nënshkruar ankesën janë kompetent të nënshkruajnë.
3. aty ku një aplikues është i përfaqësuar në pajtim me Rregullën 17δ 1, një autorizim i avokatit apo autorizim me shkrim duhet të sigurohet nga përfaqësuesi i tij apo saj.

#### *Rregulla 26. Përmbajtja e ankesës*

1. një ankesë duhet të ekspozoj:
  - a. identiteti i aplikuesit dhe i ankuesit, nëse është tjetër nga aplikuesi, përfshirë, vendin e duhur, emrin, datën e lindjes, profesionin dhe adresën e personit me fjalë;
  - b. emrin, profesionin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ndonjë;
  - c. një deklaratë të gjitha fakteve relevante;
  - d. një deklaratë të ngjeshur në pajtim me kriterin e pranimit shtruar në Nenin 3 të Rregullores Nr. 2006/12;
  - f. riparimi i UNMIK-ut.
2. aplikuesi mund të bashkëngjis çdo dëshmi dokumentuese në ankesë. Aplikuesi duhet në çdo rast të parashtror kopje të vendimeve, gjyqësore apo jo; që kanë lidhje me objektiven e ankesës apo të shfaq që kriteri i pranueshmëris ka qenë përmbushur.
3. aplikuesi mund të përdor formën standarde të siguruar nga Sekretariati.

#### *Rregulla 27. Regjistrimi i ankesës*

Zyrtari Ekzekutiv duhet të mbaj një regjistër të ankesave, në të cilën duhet të hyj data e regjistrimit dhe data e përfundimit të procedimeve.

### **C. Ekzaminimi i pranueshmërisë**

#### *Rregulla 28. Emërtimi i raportuesit*

1. Kryetari duhet të emërtoj një anëtar si raportues, cili duhet të ekzaminoj ankesën.

2. Në ekzaminimin e tyre të ankesës raportuesi

- a. mund të kërkoj palët të parashtrajnë, brenda një kohe specifike, informatë faktike, dokumente apo material tjetër cilin ata e konsiderojnë të jetë relevant;
- b. duhet të parashtrajnë raporte të tilla, skica dhe dokumente tjera cilat mund të ndihmojnë Panelin në bartjen e funksioneve të saj.

*Rregulla 29. vendimi i papranueshmërisë pa komunikimin e ankesës me UNMIK*

Paneli mund menjëherë të deklaroj që ankesa është e papranueshme apo ta përjashtoj atë.

*Rregulla 29bis. Vendimi për pranueshmërinë pa ia komunikuar kërkesën UNMIK-ut*

Paneli gjithashtu mund të shpallë menjëherë se kërkesa është pranuar, kur kërkesa ngrit çështje të cilat në thelb janë të njëjta me ato që janë ngritur në kërkesa të tjera, të cilat veç janë shpallur të pranueshme nga Paneli, dhe kur nuk del ndonjë çështje e re mbi pranueshmërinë.<sup>1</sup>

*Rregulla 30. Komunikimi i ankesës me UNMIK dhe procedimet me shkrim*

1. alternativisht, Paneli mund të vendos të
  - a. të kërkoj nga palët të parashtrajnë çdo lloj informate faktike, dokumente apo materiale tjera të konsideruara nga Paneli të jenë relevante;
  - b. të jap njoftimin mbi ankesën te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe të ftoj UNMIK-un të parashtraj observimin me shkrim mbi ankesën dhe, pastaj pas pranimit, të ftoj ankuesin të parashtraj observimet në përgjigje;
  - c. të ftoj palët të parashtrajnë observime të mëtutjeshme me shkrim.

2. para se të marr vendimet e saj mbi pranueshmërinë, Paneli mund të vendos, ose në kërkesën e një pale apo me propozimin e saj, të mbaj një seancë dëgjimore nëse e konsideron që shkarkimi i funksioneve të saj nën Rregulloren No. 2006/12 kërkon ashtu. Në atë rast, vetëm nëse Paneli vendos me përjashtim ndryshe, palët duhet të ftohen të drejtojnë çështjet cilat ngritën në lidhje me meritat e ankesës.

*Rregulla 31. Deklarimi i Papranueshmërisë*

Çdo deklaram i papranueshmërisë duhet, aq sa rrethanat dhe karakteri i saj lejojnë, të parashtrohet nga UNMIK-u në observimin me shkrim apo gojor mbi pranueshmërinë e ankesës parashtruar si e siguruar në Rregullën 30.

*Rregulla 32. Vendimi mbi pranueshmërinë*

1. vendimi i Panelit duhet të përmbaj një përshkrim të fakteve, gjithashtu dhe arsyet në pikat e ligjit. Duhet të thuhet nëse është bërë njëzëri apo nga shumica.

---

<sup>2</sup>Rregulla 29bis e përfshirë më 11 shtator 2009.

2. çdo anëtar cili ka marr pjesë në konsiderimin e rastit duhet të ketë të drejtën të shtoj në vendimin e Panelit ose një opinion të ndarë, se është i një mendimi me apo në mospajtim me atë vendim, apo një deklaram të zhveshur mospajtimi.

*Rregulla 33. Ekzaminim i përbashkët i pranueshmëris dhe meritave*

1. Gjatë vendimit të epet njoftimi i ankuesit të UNMIK-u në pajtim me Rregullën 30 § 1b, Paneli mund të vendos të ekzaminon pranueshmërin dhe meritat në të njëjtën kohë.
2. nëse Paneli është i kënaqur, në dritën e argumenteve të palëve, që rasti është i pranueshëm dhe i gatshëm për caktimin e meritave, do të adoptoj menjëherë një opinion përfshirë vendimin e Panelit mbi pranueshmërin.

**D. Egzaminimi i meritave**

*Rregulla 34. Procedimet pas pranueshmëris të ankesës*

1. në momentin kur një ankesë është deklaruar e pranueshme, paneli mund të ftoj palët të parashtrijnë dëshmi të mëtejshme dhe observime me shkrim.
2. Paneli mund të vendos, ose mbi kërkesën e një pale apo me propozimin e saj, të mbaj një seancë mbi meritat nëse e konsideron që shkarkimi i funksioneve të saj nën Rregulloren 2006/12 kërkon.
3. paneli duhet, ku është e duhur, të rregulloj procedurën me shkrim dhe gojë.

*Rregulla 35. Opinioni mbi meritat*

1. në pajtim me Nenin 17.1 të Rregullores Nr. 2006/12, Paneli duhet të adoptoj një opinion me përmbajtje të gjeturave të saj nëse aty ka pasur një shkelje të drejtave të njeriut të ankuesit.
2. në pajtim me Nenin 17.1 të Rregullores Nr. 2006/12, Paneli mundet, kur e sheh të nevojshme, të bëj rekomandime bazuar në të gjeturat. Këto rekomandime mund të lidhen, në veçanti, në riparimin e masave cilat duhet të merren duke përcjellur gjetjen e shkeljes së drejtave të njeriut të ankuesit.

*Rregulla 36. Forma e opinionit*

1. opinionit duhet të përmbaj:

- a. emrin e anëtarëve të Panelit cilët kanë participuar në adoptimin e opinionit, dhe emrin e Zyrtarit Ekzekutiv të Sekretariatit;
- b. datën në të cilën është adaptuar;
- c. një përshkrim i palëve dhe përfaqësuesve të saj;
- d. një raport mbi procedurën e percjellur;
- e. faktet e rastit;
- f. një përmbledhje të parashtrësive nga palët;
- g. arsyet në pikat e ligjit;
- h. dispozitat operuese;
- i. numri i anëtarëve cilët përbëjnë shumicën.

2. çdo anëtar cili ka marr pjesë në konsiderimin e rastit duhet të ketë të drejtë në shtoj në vendimin e Panelit ose një opinion të ndarë, se është i një mendimi apo në mospajtim me atë mendim, apo një deklaram të zhveshur të mospajtimit.

## **E. Dëshmia**

*Rregulla 37. Dëshmia mbi të cilën vendimet dhe opinionet janë bazuar*

Paneli duhet të bazoj vendimet dhe opinionet e saj në çdo dëshmi cilën e konsideron relevante te ankuesi, përfshirë dhe dëshminë e mbledhur me vet-iniciativ.

*Rregulla 38. Parashtrimi i dëshmisë shtesë nga palët*

Palët mund të shtojnë dëshmi shtesë në çdo kohë gjatë procedimeve, deri kur Paneli përfundon konsiderimin e rastit. Paneli mundet sidoqoftë, kur është e nevojshme për kryerje të duhur të detyrave të saj nën Rregulloren Nr. 2006/12, të vendos një kufizim kohe për parashtrimin e dëshmive të tilla.

*Rregulla 39. Masat hetuese*

1. Paneli mundet, në kërkesë të palës apo me propozimin e saj, të adoptoj çdo masë hetuese cilën e konsideron të aftë të qartësoj faktet e rastit.
2. paneli mundet, *inter alia*, në pajtim me nenin 15.1 të Rregullores Nr. 2006/12, të kërkoj shfaqjen e çdo personi, përfshirë personelin e UNMIK-ut, si dëshmitar apo ekspert apo në ndonjë kapacitet tjetër, apo parashtrimin e çdo dokumenti, përfshirë dosjet dhe dokumentet në posedim të UNMIK-ut, cilat mund të jenë relevante te ankuesi. Kërkesa për shfaqjen e personelit të UNMIK-ut apo për parashtrimin e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara duhet të parashtrihen te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe të veprohet mbi të në pajtim me nenin 15.3 të Rregullores Nr. 2006/12.

*“Rregulla 39bis. Kërkesat për kufizimin dhe zbulimin e dëshmive*

1. Secila palë mund të kërkojë nga Paneli që të mos i zbulojë palës tjetër në procedurë dëshmitë e dorëzuara nga ajo palë, në mënyrë që të mbrohet interesi i rëndësishëm publik ose të ruhen të drejtat fundamentale të ankuesit apo të personave të tjerë në fjalë. Çdo kërkesë e tillë do të përfshijë arsyet dhe do të përcaktojë nëse kërkohet kufizimi i plotë apo i një pjese të informacioneve të paraqitura. Paneli do të vendosë për kërkesën në baza *ex parte*.
2. Nëse Paneli e miraton kërkesën, e njofton palën tjetër për vendimin e tij dhe vepron në përputhje me këtë. Për aq sa nuk e dëmton karakterin konfidencial të informacioneve të pranuar, Paneli do të tregojë natyrën e informacioneve të pranuar në besim. Paneli ka mundësi të bazojë vendimet e veta në dëshmitë e pranuar në besim.

<sup>3</sup>Rregulla 39bis e përfshirë më 21 nëntor 2009



3. Nëse Paneli nuk e pranon kërkesën ose nëse e pranon pjesërisht, palën kërkuese e njofton për vendimin e tij dhe i jep mundësi që ajo të rishqyrtojë çështjen e dorëzimit të dëshmisë pranë Panelit.

*Rregulla 39 ter. Konfidencialiteti i dëshmive të mbledhura nga Paneli me iniciativën e tij*

Nëse Paneli pranon dëshmi nga pala e tretë sipas kushtit të konfidencialitetit, ato dëshmi nuk ua bën të ditura asnjërës palë. Paneli do të ketë mundësi që vendimet e veta t'i bazojë në dëshmitë e pranuar në besim.”

## **F. Seancat dëgjimore**

*Rregulla 40. karakteri Publik i seancave dëgjimore*

Në pajtim me nenin 16.1 të Rregullores Nr. 2006/12, seancat duhet të bëhen në publik, vetëm nëse Paneli në situata të jashtëzakonshme vendos ndryshe.

*Rregulla 41. Kryerja e seancave dëgjimore*

1. Kryetari i Panelit duhet të organizoj dhe të drejtoj seancat dëgjimore dhe duhet të përshkruaj urdhrin në të cilin ata cilët shfaqen para panelit duhet ftuar për të folur.
2. Çdo anëtar i Panelit mund ti parashtrij pyetje çdo personi cili shfaqet para Panelit.

## **G. Nënshkrimi, shpërndarja, njoftimi dhe publikimi i vendimeve dhe opinioneve**

*Rregulla 42. nënshkrimi i vendimeve dhe opinioneve*

Vendimet dhe opinionet duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe Zyrtari Ekzekutiv i Sekretariatit.

*Rregulla 43. Shpërndarja e vendimeve dhe opinioneve*

Vendimet dhe opinionet duhet të shpërndahen me shkrim.

*Rregulla 44. njoftimi i vendimeve dhe opinioneve*

Vendimet dhe opinionet duhet të iu njoftohen palëve.

*Rregulla 45. publikimi i vendimeve dhe opinioneve*

Vendimet dhe, në pajtim me Nenin 17.2 të Rregullores Nr. 2006/12, opinionet duhet të publikohen në Anglisht, Shqip dhe Serbisht.

<sup>4</sup>Rregulla 39ter e përfshirë më 21 nëntor 2009.

## **H. Revizioni dhe Korrigjimi i gabimeve**

### *Rregulla 46. kërkesa për revizion të një vendimi apo opinionioni*

1. një palë mundet, në rast të zbulimit të faktit cili nga natyra e tij mundet të ketë ndikim vendimtar dhe i cili, kur vendimi apo opinionioni është shpërndarë, ka qenë i panjohur te Paneli dhe me arsyetim nuk ka qenë i njohur te ajo palë, të kërkoj nga Paneli, brenda një periudhe të një muaji pasi ajo palë kishte fituar njohuri të faktit, të rindreq atë vendim apo opinionion.
2. kërkesa duhet të përmend vendimin apo opinionin revizioni i cilit është kërkuar dhe duhet të përmbaj informata e nevojshme të shfaq që kushtet e shtruar poshtë në paragrafin 1 janë përpiluar me të. Duhet ti bashkëngjitet një kopje e të gjitha dokumenteve mbështetëse.
3. Paneli mundet të refuzoj kërkesën në bazën që aty nuk ka arsye të justifikoj marrjen e saj parasysht.
4. nëse Paneli nuk e refuzon atë kërkesë, do ta komunikoj te pala tjetër apo palët dhe do ti ftoj ato të parashtrorjnë komente brenda kufizimit të kohës të caktuar nga Paneli. Paneli gjithashtu duhet të rregulloj edhe datën e seancës dëgjimore cilën Paneli duhet të vendos ta mbaj një.

### *Rregulla 47. Korrigjimi i gabimeve dhe revizioni redaksional*

1. Pa paragjykime ndaj Rregullës 46, Paneli mundet, me propozimin e saj apo me kërkesën e palës bërë brenda një muaji nga shpërndarja e një vendimi apo opinionioni, të korrigjoj gabimet klerikë, gabimet në kalkulim apo gabimet e dukshme.
2. vendimet dhe opinionet janë subjekt i revizionit redaksional.

## **I. Devijimi**

### *Rregulla 48. devijimi në rastet individuale*

Dispozita në këtë kapitull nuk ndalojnë Panelin nga devijimi i tyre në konsiderimin e një rasti të veçante, aty ku e nevojshme për kryerjen e detyrave të saj në mënyrë të duhur nën Rregulloren Nr. 2006/12.

## **Kapitulli 5. Dispozitat përfundimtare**

### *Rregulla 49. çështjet jo të qeverisura nga Rregullat e procedurës*

Çështjet jo të qeverisura nga Rregullat e tanishme procedurale duhet të vendosen nga Paneli, cilat duhet të bazojnë vendimin tyre në dispozitat e Rregullorës Nr. 2006/12 dhe, aq sa është e mundur, në rregullat e Gjykatës të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

### *Rregulla 50. versionet e gjuhëve të rregullave të procedurës*

Rregullat e tanishme të Procedurës janë adoptuar në Gjuhën Angleze, tekst cili duhet të përbej versionin origjinal. Teksti pastaj duhet të përkthehet në Shqip dhe Anglisht.